



Strategji për Republikën e Maqedonisë së Veriut

2025-2030

Miratar nga Bordi i Drejtorëve më 30 prill 2025



European Bank
for Reconstruction and Development



“Përkthimi i tekstit origjinal të dokumentit është bërë nga BERZH-i vetëm për nevojat e lexuesit. BERZH-i e siguron autenticitetin e përkthimit, por BERZH-i nuk e garanton apo autorizon saktësinë e përkthimit. Mbështetja në saktësinë e një përkthimi të tillë është në rrezik të lexuesit. Në asnjë rrethanë BERZH-i, punonjësit ose përfaqësuesit e tij nuk do të jenë përgjegjës ndaj lexuesit ose kujtdo tjetër për çdo pasaktësi, gabim, lëshim, fshirje, mangësi dhe/ose çdo ndryshim në përmbajtjen e përkthimit, pavarësisht nga shkaku ose dëmi që do të rezultonte prej tij. Në rast të ndonjë dallimi ose kontradikte midis versionit në gjuhën angleze dhe versionit të përkthyer, versioni në gjuhën angleze do të jetë relevant.”

Përmbajtja dhe fjalorthi



European Bank
for Reconstruction and Development

Përmbajtja			Fjalorthi dhe termat kryesorë		
Rezyme e shkurtër	3	IVB	Investime vjetore në biznes	PKEK	Plani kombëtar energjetik dhe klimaterik
Maqedonia e Veriut – Shqyrtim i shkurtër i aktivitetëve të BERZH	4	QPI	Qasje në politikën informatike	HJ	Hua jofunksionale
I. Implementimi i strategjisë paraprake (2019-2024)	5	KBV	Këshilla për bizneset e vogla	IFP	Institucione financiare partnere
Rezultatet kryesore të tranzicionit të arritura gjatë strategjisë paraprake	5	HKBP	Hulumtim i klimës së biznesit dhe puna e ndërmarrjeve	PPP	Partneritete publiko-private
Sfida të implementimit dhe leksionet kryesore	7	DLLV	Deficiti i llogarisë vijuese	BRE	Burime të rinovueshme të energjisë
II. Konteksti ekonomik	8	CBAM	Mekanizëm për rregullimin e emetimeve ndërkufitare të karbonit	AD	Ana e djathtë
Konteksti makroekonomik dhe parashikimet për periudhën që e përfshin strategjia	8	IÇK	Indeksi i çmimeve konsumatore	PNRR	Programi për ndarjen e rreziqeve
Sfidat kryesore të tranzicionit	9	OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile	FMBV	Fond për mbështetjen e bizneseve të vogla
III. Prioritetet e Qeverisë dhe angazhimi i palëve të interesuara	11	ESU	Ekologjike, sociale dhe udhëheqja	SECO	Organizata zvicerane për bashkëpunim ekonomik
IV. Definimi i prioriteteve të Strategjisë për Maqedoninë e Veriut	12	PES	Politika ekologjike dhe sociale	VSMJÇS	Vlerësimi strategjik për mjedisin jetësor dhe çështjet sociale
V. Korniza e aktivitetëve dhe rezultateve	13	BE	Bashkimi Evropian	NMV	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
VI. Harta e komplementaritetit të partnerëve ndërkombëtarë në fushat e punës së BERZH-it	16	IDH	Investime të drejtpërdrejta të huaja	BT	Bashkëpunim teknik
VII. Rreziqet e implementimit dhe implikimet ekologjike dhe sociale	17	FI	Institucion financiar	RRTT	Rrjeti transportues transevropian
VIII. Vlerësimi i partneriteteve me donatorë	18	PVQGJ	Plan veprimi për qytet të gjelbër	FPE	Furnizimi i përgjithshëm me energji
Aneks – Vlerësim politik	19	BPV	Bruto Prodhimi Vendor	PFT	Programi për financim tregtar
		GS	Gazra serrë	BB	Banka Botërore
		ZGV	Zinxhirët global të vlerave	BP5	Ballkani Perëndimor (pa Maqedoninë e Veriut)
		HIPCA	Partneritet me ndikim të lartë për veprim klimatik	SHEB	Shqyrtimi ekonomik botëror
		ITA	Industria, tregtia agrobiznesi	PGB	Programi „Gratë në biznes“
		TIK	Teknologji informatike dhe komunikuese	PRB	Programi „Rinia në biznes“
		ANE	Agjencia Ndërkombëtare e Energjetikës	PMJÇS	Politika e Mjedisit Jetësor dhe Çështjeve Sociale
		KNF	Korporata ndërkombëtare financiare		
		INF	Institucion ndërkombëtar financiar		
		ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës		
		FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar		
		TI	Teknologjia informatike		
		PITDE	Platforma investuese për tranzicion të drejtë të energjisë		
		AM	Ana e majtë		
		IPL	Indeksi i performancave logjistike		
		PSH	Prodhimtaria dhe shërbimet		
		VKN	Vlerësimi i kapitalit natyror		
		KPN	Kontribute të përcaktuara nacionale		

Angazhimi i Maqedonisë së Veriut drejt Marrëveshjes për formimin e Bankës dhe zbatimi i parimeve politike të përcaktuara në nenin 1, ka vazhduar që nga miratimi i Strategjisë së mëparshme të vendit, në përputhje me përpjekjet e saj për zbatimin e agjendës gjithëpërfshirëse të reformave të BE-së. Maqedonia e Veriut ishte vendi i parë nga Ballkani Perëndimor që iu dha statusi zyrtar i vendit kandidat për në BE, që në vitin 2005 dhe rekomandimi i parë i Komisionit Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin e vendit në BE daton nga viti 2009. Reformat dhe rritja sipas Planit të ri të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor përfaqëson një mekanizëm potencialisht të rëndësishëm për menaxhimin dhe mbështetjen e reformave gjithëpërfshirëse.

Rezultatet e Maqedonisë së Veriut në pikëpamje të rritjes janë më të dobëtat në Ballkanin Perëndimor që nga kriza financiare globale dhe vendi është rimëkëmbur tejte ngadalë nga Kovid-19, duke arritur të kthehet në nivelet e BPV-së të vitit 2019 madje në vitin 2022. Vendi është vendi më i hapur ndaj tregtisë në rajon, me ç'rast eksportet e mallrave janë trefishuar gjatë dekadës së fundit dhe kanë arritur në mbi 50% të BPV-së. Deri në vitin 2023 për shkak të komponentit të lartë të importit të prodhimit dhe kompleksitetit të ulët të eksportit, eksportet neto dhanë një kontribut negativ. Që atëherë importet u ngadalësuan për shkak të kërkesës së dobët të brendshme dhe rritjes së eksporteve të shërbimeve. Papunësia ka rënë nga 28.6% në 13% në dekadën e fundit, por mbetet ndër më të lartat në rajon. Punësimi i popullsisë aktive është nën 50% dhe ka ngecur që nga pandemia, me ç'rast pjesëmarrja e fuqisë punëtore është në rënie, e nxitur pjesërisht nga eksodi i madh i popullsisë së aftësuar për punë.

Mjedisi i biznesit është tërheqës për IDH-të, por më pak tërheqës për kompanitë vendore, veçanërisht NVM-të që luftojnë me pasojat e paqëndrueshmërisë politike, të mospërputhjes së aftësive dhe qasjet në financa. Mjedisi i biznesit ka ende nevojë për përmirësim pasi vazhdon të pengohet nga sfidat e vazhdueshme strukturore si sektori i rëndësishëm joformal dhe paparashikueshmëria e taksave parafiskale. Intensiteti i karbonit në ekonomi është i lartë dhe kalimi nga qymyri do të ndikojë te një numër i madh punëtorësh dhe komunitetesh. Sektori i qymyrit ka qenë tradicionalisht një punëdhënës i rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor, drejtpërdrejt dhe tërthorazi. Maqedonia e Veriut ka marrë angazhime të rëndësishme në lidhje me tranzicionin e saj të gjelbër, duke përfshirë heqjen e plotë të prodhimit të energjisë elektrike me qymyr dhe vendosjen e 1.7 gigavatëve të energjisë së rinovueshme deri në vitin 2030, investimet në rrjet dhe ruajtjen për sigurinë energjetike dhe masat mbështetëse të komuniteteve të prekura nga kalimi apo tranzicioni nga përdorimi i qymyrit. Maqedonia e Veriut e ka avancuar infrastrukturën e saj të lidhjes me mbulim gati 100% të rrjeteve 4G dhe 3G dhe duke arritur renditje konkurruese globale në pikëpamje të shpejtësisë së internetit me shtrirje të gjerë dhe për telefoninë celulare dhe fikse, por ka kapacitet të kufizuar të sektorit privat për të adoptuar teknologji të reja.

Nisur nga këto sfida, gjatë periudhës së ardhshme të strategjisë, BERZH do të vazhdojë të përqendrohet në krijimin e një ekonomie konkurruese dhe tërheqëse e cila përballet me sukses me çështjet demografike, duke e mbështetur zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme, gjelbërimin e ekonomisë dhe forcimin e integritit me rajonin me zinxhirë të vlerës globale. Partneriteti i vazhdueshëm strategjik me INF të tjera dhe mbështetja e donatorëve në formën e granteve të asistencës teknike do të jenë kyçe për Bankën për të përmbushur prioritetet strategjike të mëposhtme në Maqedoninë e Veriut midis vitit 2025 dhe 2030:

1. *Mbështetje për integrimin rajonal përmes lidhjes dhe lidhjet e përforcuara të zinxhirëve të vlerave*
2. *Përsheptimi i tranzicionit drejt një ekonomie të gjelbër dhe të qëndrueshme*
3. *Mbështetja e një ekonomie më konkurruese, gjithëpërfshirëse dhe të mirëmenaxhuar*

Maqedonia e Veriut – Shqyrtim i shkurtër i aktiviteteve të BERZH-it




European Bank
for Reconstruction and Development


Aktivite investuese të BERZH-it në Maqedoninë e Veriut (deri në nëntor të vitit 2025)

Portfoli	1,205 mil. euro	Projekte aktive	99
Pjesëmarrja në kapital	1%	Mjete operative	526 mil. euro
Pjesëmarrja në sektorin privat ¹	44%	Neto. investime kum.	2,925 mil. euro


IVB dhe operacione




Përbërja e portfolit



Dinamika e portfolit



Hendeqet në tranzicion²



Numra në kontekst të Maqedonisë së Veriut

	Maqedonia e Veriut	Treguesit krahasues
Popullsia (në milionë) ³ (2023)	1.8	BeH 3,5 Serbia 6,6 BP5 3,1
BPV për kokë banori (PFB Ndërk. \$) ³ (2024 vlerësimi)	26,912	BeH 21,498 Serbia 29,039 BP5 24,125
Dendësia e bizneseve të reja ⁴ (Regjistrime të reja për popullsi prej 1000 banorësh, 2022)	4.6	BeH 1,5 Serbia 2,5 BP5 4,0
Papunësia (%) ⁵ (2023)	13.1	BeH 10,7 Serbia 8,3 BP5 11,1
Papunësia (%) ⁵ (2023)	29.7	BeH 27,3 Serbia 24,1 BP5 26,6
Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore (%) ⁵ (2023)	42.2	BeH 42,2 Serbia 51,5 BP5 48,6
Intensiteti energjetik FPE/BPV (MXH/2015 \$) ⁶ (2022)	3.5	BeH 5,9 Serbia 5,1 BP5 4,4
Intensiteti i emetimeve/BPV (kgCO2/2015 \$) (2023) ⁶	0.7	BeH 1.0 Serbia 0.9 BP5 0.7

1. Investime kumulative të Bankës: bazë e vazhdueshme 5-vjeçare e portfolit; 2. Shiko: Raporti i tranzicionit i BERZH-it 2023-2024; 3. SHBE i FMN-së; 4. Anketë për sipërmarrësinë në BP dhe baza e të dhënave; 5. OBP; 6. ANE 7. Të dhëna për BeH nga viti 2022

1. Implementimi i strategjisë paraprake (2019-2024)




European Bank
for Reconstruction and Development


1.1. Rezultatet kryesore të tranzicionit të arritura gjatë strategjisë paraprake (1/2)

Harmonizim strategjik 2020-2025


Investime kumulative vjetore në biznes (IVB)



Ndihmë teknike dhe grante investuese




Rezultate të efektit të tranzicionit ¹



Prioriteti 1

Mbështetje e konkurrencës dhe gjithëpërfshirjes përmes përforsimit të zinxhirit të vlerave, rritjes së aftësive të fuqisë punëtore dhe përforsimit të menaxhimit

Rezultatet kryesore sasiore



Rezultate kryesore të tranzicionit

- Janë paguar 92 milionë euro për korporatat dhe NVM përmes 37 transaksioneve me IFP në kuadër të Programit të Mbështetjes së konkurrencës, Programit të Financimit të Ekonomisë së Gjellbër dhe Programeve të Ristartimit të NVM-ve.
- Fondi Financiar i Gjellbër u aktivizua me UNDP dhe u nënshkruan linjat të FFGJ me Bankën Shparkase dhe Prokredit (nga 7 milionë euro çdo bankë) dhe Shparkase Lizing (3 milionë euro).
- U prezantuan mekanizma të rinj të përfshirjes digjitale, duke arritur në më shumë se 500 sipërmarrës. Janë ofruar trajnime për 60 NVM në fushat e efikasitetit energjetik, investimeve në fazat e hershme, analizës së të dhënave dhe zgjidhjeve të TIK.
- Në nëntor 2023 startoi me sukses programi “Të rinjtë në biznes”, me kontratën e parë të nënshkruar me Bankën Procredit.
- Bursës së Maqedonisë i është ofruar mbështetje për përmirësimin e menaxhimit korporativ të kompanive të listuara dhe përgatitjen e udhëzimeve për MJÇSU për kompanitë e listuara.
- Reforma e inspektimit u mbështet me fillimin e zbatimit të sistemit e-inspektor në 13 inspektorate shtetërore në kuadër të Këshillit të Inspektimit. Sistemi onlajn për procedurat e inspektimit të digjitalizuar do të ofrojë një mekanizëm efikas për të reduktuar sjelljen subjektive të inspektorëve, do të sigurojë transparencë për bizneset dhe do të shërbejë si mjet në luftën kundër korrupsionit.

1. Rezultatet në ndikimin e tranzicionit reflektojnë se sa është e mundur projektet të arrijnë ndikimin që pritet prej tyre gjatë nënshkrimit. Përlogaritur në bazë të portfolios aktive të pjekur (> 2 vite).

1. Implementimi i strategjisë paraprake (2019-2024)



European Bank
for Reconstruction and Development

1.1. Rezultatet kryesore të tranzicionit të arritura gjatë strategjisë paraprake (2/2)

Prioriteti 2

Përforcimi i integritetit rajonal, lidhje e butë dhe mbështetje e përafrimit me BE-në

Korridori Panevropian 8




Rezultate kryesore të tranzicionit

- U sigurua hua me garanci shtetërore prej 5 milionë euro për Ministrinë e Financave për të mbështetur ndërtimin e pikës së përbashkët kufitare hekurudhore në kufirin ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.
- Është ofruar mbështetje për Portalin rajonal të Regjistrave të bizneseve nga Ballkani Perëndimor (BIFIDEX), i cili integron 5 regjistra nga rajoni, me të dhëna për më shumë se 1.5 milionë kompani dhe 2.2 milionë persona fizikë.
- Financimi i huasë prej 167.6 milionë euro për projektin TEN-T Autostrada Shkup – kufi me Kosovën, me të cilin do të përfundojë lidhja me autostradë mes kryeqyteteve të dy vendeve.
- U nënshkrua hua prej 110 milionë eurosh për Korridorin Rrugor VIII – Faza I (autostrada Kërçovë-Bukojçan) në pjesën perëndimore të Korridorit VIII drejt Shqipërisë.
- U sigurua hua me garanci shtetërore deri në 98.6 milionë euro për NOMAGAS për ndërtimin e 100% kompatibil për hidrogjen (i) të një interkonektori të gazit natyror me Greqinë (66 km; ndërlidhje) dhe (ii) tubacione gazi nga Gostivari në Kërçovë. (34 km; Seksioni 1) dhe nga Sveti Nikole në Veles (28 km; Seksioni 2), të cilat janë pjesë e rrjetit kombëtar të gazsjellësit.

Prioriteti 3

Mbështetja e tranzicionit në një ekonomi të gjelbër përmes një përzjerjeje më të qëndrueshme të energjisë dhe efikasitetit më të burimeve

Rezultatet kryesore sasore



- Kapaciteti i instaluar për BRE (RHS)
- Kursimi i energjisë primare (GXH/vit),

Rezultate kryesore të tranzicionit

Hua me garanci shtetërore prej 55 milionë eurosh për të mbështetur një projekt pionier në sektorin e mbetjeve të ngurta që lanson shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në përputhje me BE-në që mundëson zhvillimin e deponive sanitare, ndërtimin e stacioneve të reja të ngarkimit, një qendre riciklimi, si dhe furnizimin e pajisjeve të reja të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

Është mobilizuar financim koncesionar dhe grante prej 85 milionë dollarësh nga CIF për të përshpejtuar tranzicionin e drejtë nga termocentralet me qymyr.

Është nënshkruar financim me EMV-në për centrale shtesë fotovoltaike 40 MW mbi minierat e varfëruara të qymyrit në Manastir dhe Oslomej, në shumë totale prej 31 milionë eurosh. Kapaciteti total i energjisë së rinovueshme të instaluar me mbështetjen e BERZH: 46 MW që nga viti 2019.

Nënshkruhet hua prej 100 milionë eurosh për mbështetjen e likuiditetit me EMV-në, e cila përfshin një Plan veprimi gjithëpërfshirës për rristurimin dhe dekarbonizimin e sektorit të energjisë, me objektiva për një reduktim neto prej 82% të GS deri në vitin 2030 dhe sigurimin e 1.7 GW të impianteve të reja për BRE deri në vitin 2030.

Plani i parë i veprimit për qytetin e gjelbër, i cili identifikon veprimet prioritare politike dhe investimet për të mbështetur zhvillimin e gjelbër, u miratua nga Qyteti i Shkupit në tetor 2020. Është miratuar hua me garanci shtetërore prej 10 milionë eurosh për blerjen e 33 autobusëve me GNK për të ofruar shërbime adekuate të transportit publik. Kredi me garanci shtetërore prej 68 milionë eurosh për bashkëfinancim, së bashku me BEI dhe WBIF, të prezantimit të parë të trajtimit të ujërave të zeza në Shkup.

1.2. Sfidat e implementimit dhe leksionet kryesore

Konteksti i implementimit

Ndikimi i Kovid-19, i ndjekur nga kriza energjetike dhe inflacioni i lartë i përkeqësuan një sërë sfidash paraekzistuese për Maqedoninë e Veriut, pasi vendi tashmë po përballlej me sfida endemike si nivelet e larta të emigrimit, produktiviteti i ulët dhe infrastruktura e vjetruar. Për të përmirësuar konkurrencën e ekonomisë, më shumë kompani vendore duhet të përfshihen në zinxhirët e vlerës globale dhe të rrisin produktivitetin. Kriza energjetike e vitit 2022 ka zbuluar dhe intensifikuar dobësitë në sektorin energjetik të Maqedonisë së Veriut, duke zbuluar rreziqet e një përzierjeje të pamjaftueshme të prodhimit të energjisë elektrike dhe integritetit të dobët në tregun rajonal.

Kriza ka nxjerrë në pah dështimet e termocentraleve të vjetra me qymyr dhe sfidat e paraqitura nga mungesa e ujit që ndikon në prodhimin e hidroenergjisë. Vitet e rënies së prodhimit vendor të energjisë, i nxitur nga investimi i pamjaftueshëm në infrastrukturën e re dhe mirëmbajtja e objekteve ekzistuese, e kanë bërë Maqedoninë e Veriut veçanërisht të nënshtruar ndaj paqëndrueshmërisë së çmimeve të energjisë. Koncepti i një "tranzicioni të drejtë" është i rëndësishëm për Maqedoninë e Veriut, veçanërisht në rajonet që varen shumë nga qymyri. Këto zona përballen me sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe largimi nga qymyri si pjesë e një tranzicioni më të gjerë drejt burimeve më të gjelbra të energjisë rrezikon t'i përkeqësojë këto probleme. Nënshkrimi i Deklaratës së përbashkët për një platformë investimesh të tranzicionit të drejtë të energjisë në dhjetor të vitit 2023, vitin e kaluar shënoi një hap përpara në zgjidhjen e këtyre çështjeve. Megjithatë, suksesi i kësaj nisme varet nga sa efektivisht zbatohet. Plani i rritjes së BE-së përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të çuar përpara reformat kryesore në vend. Duke u përafëruar me standardet e BE-së dhe duke përfutur nga mbështetja e ofruar nëpërmjet këtij plani, vendi mund të zgjidhë shumë nga çështjet e tij strukturore, nga reformat në qeverisje deri te zhvillimi i infrastrukturës.

Sfidat e implementimit

- Emigrimi i vazhdueshëm, perspektiva e dobët makroekonomike dhe madhësia relativisht e vogël e sektorit privat i kufizojnë mundësitë për investime.
- Aftësitë dhe kapacitetet e kufizuara të administratës publike e pengojnë ritmin e zbatimit të projekteve të sektorit publik.
- Inflacioni i lartë dhe rritja drastike e çmimeve të energjisë kanë nxjerrë në pah mangësi strukturore në sektorin e energjisë dhe në linjë të fundit cenueshmërinë e ekonomisë ndaj goditjeve të jashtme.
- Paqëndrueshmëria e çmimeve në tregun e energjisë elektrike ka ulur atraktivitetin e kontratave afatgjata të blerjes së energjisë elektrike, duke e kufizuar kështu realizimin e projekteve të mëdha të energjisë së rinovueshme.

Leksionet kryesore dhe hapat e ardhshëm

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm i ngushtë me donatorët dhe FMN-në për të siguruar grante të mjaftueshme dhe financim projektësh. Është e rëndësishme të përdoren grantet e bashkëinvestimit dhe BT për të përmirësuar qasjen financiare. Kalimi në marzhe fikse dhe jo të ndryshueshme ose kombinimi i fondeve të BERZH me financat koncesionare.
- Bashkëpunim i ngushtë dhe i rregullt me autoritetet e portofolit të sektorit publik dhe përsheptimi i zbatimit. Rritja e mbështetjes këshillimore për subjektet publike për të përmirësuar përgatitjen dhe zbatimin e projekteve. Kërkimi i mundësive për përdorimin e kushteve të Planit të rritjes së BE-së për t'i çuar përpara reformat.
- Është e rëndësishme t'i ofrohet mbështetje e vazhdueshme sektorit privat, si financiar (drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet IFP) ashtu edhe këshilluese, për ta ndihmuar atë të përballlet me ndikimin e krizave. Zhvillimi i vazhdueshëm i produkteve të reja (p.sh. programet e ndarjes së rrezikut me çmime të tjera rezervë) dhe përmirësime të mëtejshme të proceseve operative.
- Të vazhdohet me mbështetjen e politikave për të hequr barrierat ndaj projekteve komercialisht të qëndrueshme në sektorin e energjisë së rinovueshme.

2. Konteksti ekonomik

2.1. Konteksti makroekonomik dhe parashikimi i periudhës që e përfshin strategjia



European Bank
for Reconstruction and Development

Maqedonia e Veriut – Treguesit kryesorë makroekonomikë

	2021	2022	2023	2024
Rritja e BPV-së (% vit pas viti)	4,5	2,8	2,1	2.8
CPI inflacioni (% mesatarja)	3,2	14,2	9,4	3,5
Bilanci qeveritar (% nga BPV)	-5,4	-4,4	-4,6	-4,4
Bilanci vijues (% nga BPV)	-2,8	-6,1	0,4	-2,3
Neto IDH (% nga BPV) <i>[minusi shënon të ardhura]</i>	-3,3	4,9	-3,3	-7,1
Borxhi i jashtëm (% nga BPV)	80,9	81,5	77,9	79,9
Bruto rezervat (% nga BPV)	30,8	29,2	31,1	32,6
Bruto borxhi i përgjithshëm qeveritar (% nga BPV)	51,4	49,7	49,8	53,8
Shkalla e papunësisë (%)	15,4	14,4	13,1	12,4
BPV Nominal (miliarda \$)	13,997	13,945	15,768	16,694

Rritja ekonomike ka qenë e dobët që nga kriza financiare, ndërsa në vitet e fundit për shkak të rritjes së dobët në Eurozonë dhe tensioneve gjeopolitike. Rritja u përshpejtua në 2.8 përqind në vitin 2024, e nxitur nga shpenzimet dhe investimet qeveritare, si dhe nga ndërtimi dhe shërbimet.

Inflacioni arriti nivelin më të lartë (prej 19.8 për qind në tetor 2022) në Ballkanin Perëndimor. Ai ra deri në gusht të vitit 2024, duke arritur në 2.2 për qind, por është rritur nga ai nivel për shkak të rritjes së shpejtë të pagave reale dhe politikës fiskale ekspansioniste.

Maqedonia e Veriut është ekonomia më e hapur në Ballkanin Perëndimor, me raportin e tregtisë ndaj BPV-së që tejkalon 140 për qind, por kompleksiteti i ulët i ekonomisë dhe shkalla e ulët e integritimit të kompanive vendore në zinxhirët global të vlerës kontribuojnë për deficit tregtar të lartë, i cili u ul përkohësisht në vitin 2023 për shkak të inflacionit të lartë, si dhe uljes së kërkesës së brendshme.

Deficiti fiskal deri diku është ulur nga viti 2020, por është ende i lartë mbi 4 për qind të BPV (dyfish më shumë nga niveli i vendeve). Borxhi publik është relativisht i lartë dhe është mbi 50 për qind e BPV-së dhe rritet, duke e kufizuar hapësirën fiskale për investimet publike shumë të nevojshme.

Shkalla e papunësisë ka rënë nga 30 për qind në nën 13 për qind në dekadën e fundit, por është ende ndër më të lartat në rajon. Shkalla e punësimit është nën 50 për qind e popullsisë aktive dhe ka ngecur që nga pandemia, ndërsa shkalla e pjesëmarrjes është në rënie për shkak të emigrimit të madh të popullsisë së aftë për punë.


2. Konteksti ekonomik

2.2 Sfidat kryesore të tranzicionit (I/II)

Konkurrenca

- Rritja e dobët e produktivitetit të punës po e pengon konvergjencën e të ardhurave dhe pagave: me këtë ritëm, niveli mesatar i të ardhurave për frymë në BE nuk do të arrihet as në tre breza.
- Kompleksiteti i ekonomisë është duke u përmirësuar, por është ende i ulët dhe i përqendruar në disa segmente të ngushta (industria e automobilave). Integrimi i ulët i kompanive vendore në ZGV.
- Mjedisi i biznesit pengohet nga sektori i konsiderueshëm informal dhe tarifat e shumta parafiskale.
- CBAM mund të ndikojë negativisht në konkurrencë.


Pengesat kryesore të udhëheqjes së biznesit (% e firmave)



Udhëheqja e mirë


- Standardet e udhëheqjes janë përmirësuar me kalimin e kohës dhe mesatarisht janë të përafërta me ato në rajon, por vazhdojnë të mbeten prapa niveleve të BE-së.
- Perceptimi i korrupsionit është i lartë, ndërsa lidhjet politike konsiderohen si faktori më i rëndësishëm për sukses.
- Sistemi ligjor shihet si joefektiv dhe zyrtarët qeveritarë shihen si pak llogaridhënës.
- Barra e lartë administrative dhe rregullatore për kompanitë i shtyn ato në punë joformale. Me gjithë progresin e vogël sa i përket digjitalizimit të administratës publike, ka ende shumë punë për të bërë në këtë drejtim.
- Intensiteti i karbonit është i lartë thajse dyfish nga BE27. Prodhuuesit e energjisë elektrike dhe nxehtësisë kontribuojnë më pothuajse 60 për qind të emetimeve të CO₂, pas tyre pason sektori i transportit.

Treguesit e udhëheqjes



Energjia e gjelbër

- Aktualisht, sektori i energjisë është shumë i varur nga lëndët djegëse fosile, por vendi është i përkushtuar ndaj dekarbonizimit.
- Pjesëmarrja e burimeve të rinovueshme (energji e erës dhe diellit, biogazi) është dyfishuar në prodhimin e energjisë elektrike midis vitit 2021 dhe 2024, por pjesëmarrja e tyre mbetet më e ulët në 9 për qind.
- Rëndësia e pjesëmarrjes së sektorit privat në burimet e rinovueshme të energjisë është e njohur, por nevojitet një qasje më strategjike për të arritur qëllimet ambicioze të tranzicionit të gjelbër.




2. Konteksti ekonomik

2.2 Sfidat kryesore të tranzicionit (II/II)

Gjithëpërfshirja

- Ka përmirësim të caktuar në tregun e punës ku shënohet ulje e vazhdueshme e normës së papunësisë, por ulja e numrit të popullsisë ndikon negativisht në ofertën e fuqisë punëtore dhe perspektivat afatgjata.
- Emigrimi është një sfidë e madhe, ku një e treta e popullsisë së lindur në Maqedoninë e Veriut jeton jashtë vendit. Strategjia e kapitalit njerëzor është duke u zhvilluar për një kohë të gjatë.
- Mospërputhja e rrënjësor e aftësive dhe rezultatet e dobëta arsimore reflektohen në normat e larta të papunësisë afatgjatë dhe mungesat e fuqisë punëtore.
- Ka pasur rritje të pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në fuqinë punëtore, por ekziston akoma një hendek.

Treguesit e tregut të punës
(në mijëra majtë dhe % e popullsisë prej 15 deri 64)




Integrimi

- Mangësitë e rëndësishme të infrastrukturës po adresohen gradualisht, por planifikimi më i mirë është kritik duke pasur parasysh hapësirën e kufizuar fiskale dhe nevojat e mëdha për investime publike.
- Rrugët janë mënyra më e përhapur e transportit, por shkalla e lartë e vdekjeve kërkon përmirësimin e sigurisë rrugore.
- Në Korridorin X po ndërtohet pika e parë e përbashkët kufitare hekurudhore ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.
- Modernizimi i rrjetit hekurudhor është duke u zhvilluar, por pjesë të mëdha të korridoreve hekurudhore mbeten të mbyllura, hekurudhat janë të pashfrytëzuara ndërsa reformat e tjera sektoriale kanë ngecur mbrapa.

Kapitali për frymë


(2017 PFB në mijëra dollarë për frymë)



Rezistenca

- Të hyrat e IDH gjatë dekadës së kaluar janë rritur, por kapitali për frymë mbetet i ulët.
- Sektori bankar është i mirëkapitalizuar dhe i dominuar nga bankat e huaja. Dobësitë kryesore janë euroizimi i lartë dhe mospërputhjet e maturitetit.
- Tregjet e kapitalit janë në një fazë të hershme zhvillimi, me kushte të përshtatshme makroekonomike dhe infrastrukturore të pranishme, por ende nuk ka një kuadër ligjor dhe rregullator të zhvilluar mjaftueshëm dhe ka likuiditet të ulët, thellësi dhe diversifikim të instrumenteve.
- Sektori i energjisë është i varur nga lëndët djegëse fosile, shumë i varur nga importet dhe subjekt i goditjeve të jashtme.
- Zëvendësimi i kapaciteteve të vjetruara të prodhimit të energjisë dhe çmimet e subvencionuara për familjet po bëjnë presion mbi çmimet e energjisë.

Prodhimi i energjisë elektrike për burim dhe konsum (në GWh)



3. Prioritetet e Qeverisë dhe angazhimi i palëve të involvuara



European Bank
for Reconstruction and Development

3.1 Prioritete reformuese qeveritare

Maqedonia e Veriut, për sa i përket **Kontributeve të saj të përcaktuara në nivel kombëtar (KPK)**, ka vendosur objektiva për të reduktuar emetimet e gazrave serrë me 52% ose për të arritur një reduktim neto prej 82% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 1990. Maqedonia e Veriut është e përkushtuar të heqë qymyrin dhe synon të arrijë 38% konsum të energjisë së rinovueshme deri në vitin 2030, si pjesë e **Strategjisë Kombëtare të Energjisë dhe Planit Klimatik**.

Platforma investuese e tranzicionit të drejtë energjetik e nisur në COP28 së bashku me Komisionin Evropian, BIE, Fondet Investuese Klimaterike, Bankën Botërore, IFC, KfV, CEB dhe Kaza depoziti e prestit synon të ndihmojë në mobilizimin e deri në 3 miliardë eurove për investime, politikë dhe asistencë teknike për ta përshpejtuar tranzicionin energjetik të vendit dhe vendosjen e 1.7 GW të kapaciteteve të reja të energjisë së rinovueshme deri në vitin 2030, së bashku me rjetin dhe infrastrukturën e deponimit. Paketa e mbështetjes është krijuar për të siguruar rezultate pozitive të tranzicionit të gjelbër duke mbrojtur vendet e punës dhe jetesën e komuniteteve të prekura.

Strategjia kombëtare e zhvillimit 2024-2044 i përcakton qëllimet kryesore të zhvillimit kombëtar, fushat strategjike dhe prioritetet për zhvillim të përshpejtuar, gjithëpërfshirës, të balancuar, të përgjegjshëm gjinor dhe të qëndrueshëm të Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh aspiratat e vendit për të hyrë në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030 dhe angazhimin për zhvillim të qëndrueshëm në kuadër të Agjendës 2030. Strategjia fokusohet në gjashtë prioritetet strategjike:

1. Një ekonomi e bazuar në njohuri, inovacione dhe digjitalizim, një ekonomi shumë e integruar në tregtinë ndërkombëtare dhe financat ndërkombëtare dhe një fuqi punëtore që i plotëson nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës;
2. Zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal që siguron kohezion;
3. Revitalizim demografik dhe zhvillim social dhe kulturor;
4. Sundim të ligjit dhe qeverisje të mirë;
5. Një shoqëri të sigurt dhe rezistuese; dhe
6. Transformim të gjelbër

Strategjia Kombëtare e TIK 2023-2027 vendos një vizion për një të ardhme digjitale të shkathët për Maqedoninë e Veriut që fokusohet në fushat prioritare në sektorin e TIK-ut me qëllim që të plotësohen nevojat në rritje të shoqërisë për lidhje, për të forcuar konkurrencën, për të përmirësuar jetën e përditshme të qytetarëve dhe bizneset të bëhen “më të zgjuara”. **Strategjia për specializim të mençur 2023-2027** fokusohet në mbështetjen e digjitalizimit të sektorëve kryesorë ekonomikë, duke përfshirë teknologjinë bujqësore, Industrinë 4.0 (industria elektromekanike) dhe ndërtesat inteligjente.

3.2 Fushat reformuese të BERZH-it në masë të madhe janë të harmonizuara me autoritetet

- Zhvillimi i sektorit privat duke e përmirësuar qasjen në financa, duke zhvilluar aftësi dhe duke forcuar qeverisjen korporative.
- Integrimi rajonal nëpërmjet kompletimit/përmirësimit të korridoreve dhe rrugëve kyçe evropiane dhe ndërlidhjeve energjetike.
- Ekonomia e gjelbër, me zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme, dekarbonizimin e ekonomisë.
- Përdorimi i energjisë së rinovueshme përmes zhvillimit të mëtejshëm të kornizës së ankandit dhe zgjidhjeve të ruajtjes së energjisë.
- Përmirësimi i kapaciteteve të njësive vendore është thelbësor për zbatimin e projektit.

3.3 Mesazhet kryesore nga shoqëria qytetare deri tek BERZH-i

- Shoqëria civile në Maqedoninë e Veriut e thekson nevojën për të forcuar qeverisjen e mirë duke përmirësuar: (i) pjesëmarrjen e qytetarëve, (ii) efikasitetin e sistemit ligjor dhe (iii) reformat politike dhe ligjore në lidhje me proceset e anëtarësimit në BE.
- Sektori i shoqërisë civile përballet me sfida në lidhje me qasjen në financa për gratë sipërmarrëse, pjesëmarrjen ekonomike të grave dhe ndarjen e të dhënave dhe informacionit gjinor, të cilat përfaqësojnë një mundësi për BERZH-in për të ofruar mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve për gratë sipërmarrëse.
- Sektori i shoqërisë civile theksoi se vendi duhet të përshpejtojë dekarbonizimin duke (i) investuar në tranzicionin energjetik, (ii) duke forcuar bashkëpunimin midis qeverisë dhe autoriteteve lokale, (iii) duke përdorur politika të gjelbra dhe (iv) duke ofruar trajnim profesional.

4. Përcaktimi i prioriteteve strategjike për Maqedoninë e Veriut



European Bank
for Reconstruction and Development

Çfarë duhet të ndryshojë? (Diagnostika e vendit)	A mund të ndryshojë? (Ekonomia politike)	Çfarë mund të bëjë Banka? (Kapacitetet institucionale)	Prioritete strategjike (2025-2030)	Çfarë dëshirojmë të shohim në vitin 2030
- Pavarësisht se është ekonomia rajonale më e hapur në rajon, varësia e lartë nga eksporti dhe kompleksiteti i ulët i eksportit çuan në eksporte neto negative në vitin 2023 në Maqedoninë e Veriut. - Përmirësimi i ndërlidhjeve të energjisë elektrike dhe gazit do ta balancojë rrjetin me më shumë burime të rinovueshme të energjisë dhe do të diversifikojë furnizimet me gaz, duke forcuar sigurinë energjetike. - Vendi përballlet me boshllëqe të konsiderueshme të investimeve publike në infrastrukturën ekonomike, sociale dhe mjedisore.	- Kompleksiteti i eksporteve të Maqedonisë së Veriut po rritet, i nxitur nga hyrjet e forta të IHD-ve, veçanërisht në prodhim. - Qeveria e re është e përkushtuar ta promovojë modernizimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, rinovimin e autoparkut dhe sigurinë. - Në Marrëveshjen e komunitetit transportues është përfshirë agjenda gjithëpërfshirëse për reformë në transport.	- Mbështetja e inovacionit, adoptimi i teknologjive të reja dhe zgjerimi rajonal i kompanive lokale me ndihmën e shërbimeve financiare dhe këshillimore. - Ndërtimi i kapaciteteve për autoritetet rregullatore të pavarura për të mundësuar konvergencën e tregut dhe integrimin rajonal. - Vazhdimi i financimit të infrastrukturës së transportit për të përmirësuar lidhjen rajonale për mallrat dhe njerëzit. - Promovimi i efikasitetit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së infrastrukturës përmes digjitalizimit dhe avancimit teknologjik.	Përforsimi i integritetit rajonal nëpërmjet lidhjes dhe lidhjeve të përmirësuar me zinxhirët e vlerës	- Promovimi i një ekonomie më konkurruese dhe më të mirëmenaxhuar - Ndihmë në adresimin e sfidave demografike duke përmirësuar përfshirjen ekonomike dhe zhvillimin e aftësive
- Infrastruktura publike duhet të përmirësohet për të rritur qëndrueshmërinë ndaj ngjarjeve klimatike. - Intensiteti i karbonit në ekonomi është i lartë. - Qymyri, i cili shkakton një shkallë të lartë të ndotjes, ende dominon përzjerjen kryesisht të padiversifikuar të prodhimit të energjisë elektrike - Prodhim i energjisë elektrike dhe nxehtësisë bazohet kryesisht në objekte të vjetruara, joefikase dhe të mirëmbajtura keq. - Tarifat nën koston e duhur i pengojnë investimet e nevojshme për një tranzicion më të gjelbër të energjisë dhe e kufizojnë konkurrencën në tregun me pakicë.	- Maqedonia e Veriut bëri një angazhim të hershëm për dekarbonizimin, duke synuar të reduktojë emetimet neto të gazrave serrë për 82% deri në vitin 2030 (krahasuar me nivelet e vitit 1990). - Ishte vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që miratoi një Plan Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe prezantoi një Platformë Investimi për Tranzicionin e Drejtë të Energjisë për të udhëhequr tranzicionin e tij drejt konsumit të ulët të karbonit në sektorin elektroenergetik	- BERZH-i mund të mbështesë investime të gjelbra në infrastrukturën e qëndrueshme. - Mbështetja e tranzicionit nga qymyri në energji të pastër përmes investimeve. - Promovimi i diversifikimit dhe dekarbonizimit të burimeve të rinovueshme të energjisë përmes erës, diellit, hidrocentraleve, zgjidhjeve me karbon të ulët, ruajtjes së energjisë dhe përmirësimeve të rrjetit, duke inkurajuar dialogun publiko-privat. - Lehtësimi i tregjeve të energjisë së rinovueshme përmes mbështetjes së politikave, duke përfshirë ankandet e energjisë së rinovueshme dhe integrimin e baterive për magazinim në rrjet.	Përsheptimi i tranzicionit drejt një ekonomie të gjelbër dhe të qëndrueshme	- Përsheptimi i tranzicionit të gjelbër dhe dekarbonizimi i ekonomisë - Promovimi i shërbimeve publike dhe ndërmarrjeve dhe subjekteve të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe shërbimeve komunale
- Konkurrueshmëria pengohet nga një mjedis afarist jo tërheqës, mospërputhja e aftësive dhe qasja e kufizuar në financa. - Rritja e ngadaltë e produktivitetit të punës e vonon konvergencën e të ardhurave dhe pagave. - Popullsia është në rënie, me një popullsi në plakje dhe emigracion të vazhdueshëm. - Papunësia e të rinjve është më shumë se dyfishi i mesatares së BE-27 për shkak të arsimit të dobët, mospërputhjes së aftësive dhe tranzicionit të vështirë nga shkolla në punë. - Boshllëqet gjinore në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore dhe udhëheqjen e biznesit mbeten të rëndësishme. - Masat dhe masat kundër korrupsionit për të luftuar ekonominë joformale janë ende të nevojshme.	- Privatizimi ka përparuar më shumë se në shumë vende të rajonit dhe vendi ka zhvilluar praktikat më të mira për tërheqjen e IHD-ve, duke përfshirë krijimin e zonave të lira ekonomike, reformimin e sistemit tatimor, zbatimin e një "gjitjine rregullatore" dhe diversifikimin e eksporteve, të kombinuara me reforma të tjera kryesore ekonomike. - Pjesëmarrja e grave dhe të rinjve në fuqinë punëtore është rritur vitet e fundit, por ende ekzistojnë mangësi. - Plani i rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor përfaqëson një mekanizëm potencialisht të rëndësishëm për drejtimin dhe mbështetjen e reformave që rritin rritjen.	- Forcimi i financimit direkt dhe indirekt të sektorit privat. - Mbështetja e inovacionit, digjitalizimit, automatizimit dhe sigurisë kibernetike përmes programeve të dedikuara. - Mbështetja e përfshirjes së grave dhe të rinjve përmes programeve Rinia në biznes dhe Gratë në biznes, financimit indirekt, shërbimeve këshillimore dhe reformave të politikave. - Promovimi i kapitalit njerëzor duke adresuar mangësitë e aftësive përmes trajnimit profesional (TPA) dhe nismave të tjera. - Ofrimi i shërbimeve këshillimore për NMV-të, korporatat dhe ndërmarrjet shtetërore për qeverisjen e korporatave, praktikat e burimeve njerëzore dhe planifikimin e vazhdimësisë.	Mbështetja për një ekonomi më konkurruese, gjithëpërfshirës e dhe më mirë të menaxhuar	- Promovimi i ekonomisë më konkurruese dhe më mirë të menaxhueshme - Ndihma në përballjen e sfidave demografike përmes përmirësimit të inkluzionit ekonomik dhe zhvillimit të aftësive

5. Korniza e aktiviteteve dhe rezultateve (1/3)



European Bank
for Reconstruction and Development

Prioriteti 1: Përforsimi i integritit rajonal përmes lidhjes dhe lidhjeve të përmirësuara me zinxhirët e vlerave

Qëllimet kryesore	Aktivitetet	Treguesit e monitorimit (Rezultatet)
Përmirësimi i qëndrueshmërisë, lidhjes dhe integritit të infrastrukturës kritike	- Vazhdimi i sigurimit të fondeve për infrastrukturën e transportit për të lehtësuar lëvizjen e mallrave dhe njerëzve, duke kontribuar kështu në përmirësimin e lidhjes dhe integritit rajonal. - Rritja e qëndrueshmërisë së infrastrukturës së transportit për të adresuar sfidat klimatike dhe promovimin e dekarbonizimit përmes përmirësimeve teknologjike për të reduktuar emetimet, duke përfshirë promovimin e përdorimit të automjeteve elektrike dhe infrastrukturës së karikimit, duke krijuar një kornizë rregullatore për të mbështetur dhe financuar projekte. - Promovimi i transportit hekurudhor duke e forcuar konkurrencën e sektorit hekurudhor duke mbështetur liberalizimin e tij, duke forcuar kapacitetin operacional të ofruesit të shërbimit dhe operatorit të infrastrukturës së transportit hekurudhor, si dhe duke siguruar dizajn gjithëpërfshirës të shërbimit si një multimodalitet. - Mbështetja e vazhdueshme për projektet e infrastrukturës energjetike që e përmirësojnë integritimin rajonal. - Mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve për autoritetet rregullatore të pavarura për konvergencën e tregut dhe integritimin rajonal. - Mbështetja për projektet që synojnë zgjerimin, përmirësimin dhe qëndrueshmërinë ekologjike të infrastrukturës së telekomunikacionit, duke përfshirë qendrat e të dhënave, infrastrukturën fikse me shtrirje të gjerë dhe satelitët. - Mbështetja e efikasitetit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së infrastrukturës përmes digjitalizimit, përmirësimeve teknologjike dhe përdorimit të furnizuesve të besuar të pajisjeve.	- Cilësi e përmirësuar e infrastrukturës, duke përfshirë infrastrukturën digjitale nga furnizuesit e besuar të pajisjeve (cilësore) - Përmirësimi/ritja e kapacitetit të infrastrukturës së transportit - Qasje e zgjeruar në infrastrukturë në/në të gjitha zonat urbane dhe rurale
Integritim i zgjeruar me zinxhirët e vlerave	- Mbështetja e inovacionit, pranimit të teknologjisë dhe zgjerimit rajonal të kompanive lokale nëpërmjet shërbimeve financiare dhe këshillimore, duke përfshirë shërbimet këshillimore për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe programet Shiriti blu, për të ndihmuar në rritjen e produktivitetit, konkurrencës dhe gatishmërisë për një treg të vetëm të BE-së. - Mbështetja për kompanitë e orientuara nga eksporti dhe integritimi i mëtejshëm në zinxhirët e vlerës globale. - Vazhdimi i ofrimit të financimit tregtar përmes Programit të Financimit të Tregtisë. - Tërheqja e IHD-ve në të gjithë sektorët e ekonomisë, duke përfshirë në fabrikat e prodhimit të avancuar/vlerë më të lartë të shtuar dhe objektet private, duke lehtësuar trashëgiminë e familjes dhe duke mbështetur transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin e aftësive.	- Prezantimi i suksesshëm i produkteve të reja dhe/ose të përmirësuara bankare - Vëllimi/numri i transaksioneve të Programit të financimit të tregtisë të mbështetur nga Banka

5. Korniza e aktiviteteve dhe rezultateve (2/3)



European Bank
for Reconstruction and Development

Prioriteti 2: Përsheptimi i tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbër dhe të qëndrueshme

Qëllimet kryesore	Aktivitete	Treguesit e monitorimit (Rezultate)
Përsheptimi i tranzicionit të gjelbër dhe dekarbonizimi i ekonomisë	- Mbështetja e zbatimit të Kontributit të përcaktuar kombëtar dhe objektivave të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe miratimit të masave për një tranzicion të drejtë në kuadër të Platformës së Investimeve për një Tranzicion të Drejtë Energjetik. - Promovimi i diversifikimit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe dekarbonizimi i sektorit të energjisë duke mbështetur zhvillimin e burimeve të rinovueshme të energjisë (energjisë me erë, diellore dhe hidro), duke lansuar zgjidhje me konsum të ulët të karbonit, ruajtjen e energjisë, përf forcimin e rrjetit, si dhe duke inkurajuar dialogun politik publiko-privat. - Mbështetja e krijimit të një tregu për burimet e rinovueshme të energjisë përmes mbështetjes së politikave, duke përfshirë ankandet për BRE dhe angazhimin për zhvillimin e politikave për integrimin e baterive të deponimit dhe burimeve të rinovueshme të energjisë në rrjet. - Mbështetja e masave nga ana e kërkesës, duke përfshirë mbështetjen e politikës së efikasitetit energjetik në kuadër të Programit Rajonal për Efikasitet Energjetik (REEP), zgjerimin e ofertës së financave të gjelbra dhe financimin e tranzicionit të gjelbër në segmentin e korporatave përmes konsultimit dhe financimit, duke përfshirë dhe përmes Programit për financimin e energjisë së gjelbër. - Mbështetja e dekarbonizimit të kapaciteteve të sektorit komercial dhe privat, duke përfshirë certifikimin e gjelbër dhe rezultate më të mira se sa përcaktohet në nivel kombëtar.	- Emetime të reduktuara të CO2 (kilotonë/në vit) - Kapaciteti i instaluar për energjinë e rinovueshme (MW) - Vëllimi i huave nga Programi për financimin e energjisë së gjelbër/Programi për financimin e energjisë së qëndrueshme të siguruara nga institucionet financiare partnere të mbështetura nga financat e BERZH-it. - Numri i masave të miratuara për një tranzicion të drejtë.
Promovimi i ndërmarrjeve komunale të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe subjekteve dhe shërbimeve komunale	- Rritja e qasjes në shërbimet publike dhe komunale gjithëpërfshirëse, duke përfshirë furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza, ngrohjen qendrore dhe ndërtesat/objektet publike. Përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik të kompanive të shërbimeve me fokus në prioritetet specifike të përcaktuara në Planin e BE-së për rritjen e Ballkanit Perëndimor. - Mbështetja e investimeve të efikasitetit energjetik përmes aktiviteteve ndërtimore në vend. - Mbështetja e përmirësimeve në shërbimet e mbetjeve të ngurta duke krijuar njësi të reja rajonale dhe duke e përforcuar komercializimin e sektorit duke futur një metodologji të re tarifore. - Mbështetja e zhvillimit të mënyrave të transportit më të qëndrueshëm, më të qasshme dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë, me fokus në transportin hekurudhor dhe atë urban. - Monitorimi i zbatimit të projekteve ekzistuese në kuadër të PVQGJ në Shkup.	- Kursimi i energjisë primare (gigaxhul/në vit) - Kursimi i energjisë elektrike (kWh/në vit) - Kursimi i ujit (m³/y)



5. Korniza e aktiviteteve dhe rezultateve (3/3)



European Bank
for Reconstruction and Development

Prioriteti 3: Mbështetje për një ekonomi më konkurruese, më gjithëpërfshirëse dhe më të mirëmenaxhuar

Qëllimet kryesore	Aktivitete	Treguesit e monitorimit (Rezultate)
Promovimi i një ekonomie më konkurruese, më gjithëpërfshirëse dhe më të mirëmenaxhuar	- Përforsimi i financimit direkt dhe indirekt të sektorit privat, duke përfshirë garancitë e portofolit dhe ndarjen e rrezikut, në mënyrë që të ofrohet mbështetje për konkurrencë më të madhe dhe krijimit të më shumë niveleve për konkurrencë midis kompanive vendore dhe të huaja. Gjithashtu, do të analizohen mundësitë për mobilizimin dhe lehtësimin e investimeve të diasporës në vend, aty ku ekziston mundësia. - Zgjerimi i burimeve të financimit për NVM-të dhe korporatat. Hulumtim mbi financimin e drejtpërdrejtë/kuazi-kapital. - Mbështetja e zhvillimit të tregjeve të parasë dhe kapitalit nëpërmjet këshillave për politikën dhe asistencës teknike për zgjerimin e tregjeve të letrave me vlerë dhe financimin e bankave. - Promovimi i formalizimit të ekonomisë dhe forcimi i konkurrencës së sektorit privat përmes përmirësimeve në menaxhimin ekonomik dhe përmes angazhimeve këshilluese dhe politike. - Promovimi i reformave të ndërmarrjeve shtetërore, si p.sh me përmirësime në qeverisjen e korporatave, komercializimin dhe menaxhimin strategjik të fuqisë punëtore, duke përfshirë aktivitetet që lehtësojnë arritjen e objektivave sipas Planit të Rritjes së Ballkanit Perëndimor të BE-së. - Bashkëpunimi me INF të tjera për të ofruar mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve në sektorin publik. - Përsheptimi i digjitalizimit të ekonomisë, me fokus në promovimin e aftësive digjitale, automatizimin dhe sigurinë kibernetike të ndërmarrjeve shtetërore dhe NVM-ve, duke përfshirë nismën e Digjitalizimit për NVM-të. - Mbështetja e inovacionit dhe ekosistemit të startup-eve, përmes Programit për ndërmarrjet më të mira.	- Numri i klientëve që e përmirësojnë qeverisjen e korporatës dhe/ose standardet (përfshirë ndërmarrjet shtetërore) - Numri i klientëve që prezantojnë teknologji të re ose të përmirësuar. - Numri i NVM-ve dhe korporatave të mbështetura nga BERZH të fokusuar në digjitalizim.
Ndihmë në përballimin me sfidat demografike përmes përmirësimit të përfshirjes ekonomike dhe zhvillimit të aftësive	- Forcimi i zbatimit/mbështetjes së përfshirjes ekonomike të grave dhe të rinjve përmes programeve Rinia në biznes dhe Gratë në biznes, duke përfshirë financimin indirekt dhe shërbimet këshillimore, si dhe përmes reformave të politikave. - Kontributi në zhvillimin e aftësive që janë të rëndësishme për tregun e punës përmes arsimit dhe trajnimit të zgjeruar teknik dhe profesional dhe iniciativave të tjera të aftësive për të ndihmuar në adresimin e boshllëqeve të fuqisë punëtore dhe mospërputhjeve të aftësive. - Ofrimi i këshillave për NVM-të, korporatat dhe ndërmarrjet shtetërore për përmirësimin e aftësive, praktikën e burimeve njerëzore dhe planifikimin e trashëgimtarëve. - Promovimi i diversifikimit ekonomik rajonal dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor, veçanërisht përmes iniciativave për rajone gjithëpërfshirëse dhe tranzicion të drejtë.	- Vëllimi/numri i nënkredive të paguara për Gratë në biznes/Të rinjtë në biznes dhe mundësi i këshillave afariste - Numri i njerëzve që i përmirësojnë aftësitë e tyre si rezultat i trajnimit.



6. Harta e komplementaritetit të partnerëve ndërkombëtarë në fushat e funksionimit të BERZH-it

Fushat potenciale të bashkëpunimit

		Sektorë								Tema ndërsektoriale				
		Industria, tregtia dhe agrobiznesi				Infrastruktura e qëndrueshme		FI		Nisma strategjike				
Investime/grante indikativevjetore (miliona €, 2019-2023)		Agrobiznes	Prodhimtari dhe shërbime	Patundshmëri dhe turizëm	TMT	Burime natyrore	Energjia	Infrastruktura	Banka	IFJobankare	Ekonomia e gjelbër	Gjithëpërfshirja dhe çështjet gjinore	Valuta lokale dhe tregjet e kapitalit	çeznese të vogla
EIB	126	€P					€P	€P				€P		
BB/KFN	116	€P	€				€P	€			€P	€P		€
BE	83	€					€				○			
KFW	27	€	€				€	€	€		€	€		€
BERZH	193													

€ Fusha e investimeve të rëndësishme

● Fokusi kryesor mbi sektorin privat

P Fushë e angazhimit të rëndësishëm në politika

○ Fokusi kryesor mbi sektorin publik



Ekologjia

- Vazhdimi me punë në fushën e tranzicionit/investimeve të drejta për tranzicion drejt ekonomisë së gjelbër me BE, BIE, Unionin kreditor për ripërtëritje, Bankën Botërore dhe MFK



Qëndrueshmëria

- Përforsimi i qëndrueshmërisë klimatike me Bankën Botërore



Gjithëpërfshirja

- Furnizime gjithëpërfshirëse në sektorin e mbetjeve të ngurta me mbështetje nga Programi për investime i Ballkanit Perëndimor



Integrimi

- Bashkëpunimi me BIE dhe Bankën Botërore të projekteve për integrim rajonal

Shënim: Harta e aktiviteteve të INF bazohet në informacionin e disponueshëm publikisht. Investimi i konsiderueshëm i INF-ve nënkupton projektet që tejkalojnë 5% të investimeve vjetore të nënshkruara në periudhën 2019-2023

7. Rreziqet e zbatimit dhe implikimet ekologjike dhe sociale

Rreziqet e implementimit të strategjisë	Probabiliteti	Efekti	Implikimet ekologjike dhe sociale
Paqëndrueshmëria politike dhe marrëdhëniet aktuale me vendet fqinje mund të pengojnë rrugën e integritetit evropian, duke ulur vruillin për reformat e qeverisjes.			Vlerësimi dhe menaxhimi me ndikimet ekologjike dhe sociale, angazhimi i palëve të involvuara: Sigurimi se ndikimet ekologjike dhe sociale të drejtpërdrejta, të tërthorta, kumulative dhe ndërkufitare të projekteve janë vlerësuar në mënyrë përkatëse dhe janë përshtatur me Direktivën në fuqi për VNMJ të BE-së, PMJÇS të BERZH-it dhe kërkesat për zbatim (KZ) duke i marrë parasysh konsultimet dhe informacionet e marra nga palët e involvuara. Klientët e sektorit publik mund të kërkojnë ndërtim të drejtuar të kapacitetit ekologjik dhe social me qëllim që të sigurohet harmonizim në pikëpamje të MJÇS sipas kërkesave të PMJÇS dhe Politikës/Direktivës për qasje në informacione
Mungesa e kapaciteteve administrative, qeverisja e dobët, gjyqësori joefikas, ekonomia joformale e përhapur dhe korrupsioni vazhdojnë të kenë ndikim negativ në mjedisin e biznesit dhe besimin e investitorëve.			Fuqia punëtore dhe kushtet e punës: Sigurimi se politikat e HR dhe praktikave të punës së klientëve janë në pajtim me kërkesat e BERZH-it, veçanërisht në lidhje me plotësimin e kërkesave lidhur me kushtet për punë; menaxhimin me zbatuesit, diskriminimin potencial të vendit të punës dhe promovimin e mundësive të barabarta. Vlerësimi i rreziqeve për MJÇS në sektorin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe ndikimet e uljes së fuqisë punëtore për shkak të tranzicionit drejt burimeve të pastra të energjisë. Efikasiteti i resurseve dhe parandalimi dhe kontrolli i ndotjes : Identifikimi i investimeve që e mbështesin ekonominë rrethore dhe efikasitetin e burimeve dhe futja e burimeve të njohurive mbi teknikat më të mira të disponueshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes industriale në përputhje me Direktivën e BE-së për emetimet industriale. Mbështetja e tranzicionit në një ekonomi të larmshme me konsum të ulët të karbonit dhe burimeve (përqendrimi në investime të tilla si energjia e erës/solare, ujë dhe efikasiteti energjetik) dhe përforcimi i qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike. Prioritetet e investimit të Bankës do të ndihmojnë në uljen e emetimeve të gazeve serrë, megjithëse emetimet e përgjithshme do të mbeten të larta për shkak të prodhimit të energjisë elektrike me intensitet karboni. Mbështetja e Qeverisë në promovimin e ekonomisë rrethore, në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së.
Perspektivat e dobëta makroekonomike, sfidat e rëndësishme demografike, duke përfshirë shkallën e lartë të emigrimit, shpopullimin e shpejtë dhe plakjen e popullsisë, si dhe madhësia e vogël e sektorit privat i kufizojnë mundësitë për investime.			Shëndeti dhe siguri: Përmirësimi i shëndetit dhe sigurisë gjatë punës dhe në bashkësi, me theks të veçantë në aktivitete të cilat vlerësohen për fatkeqësi të shpeshta të paraqitura gjatë projekteve të Bankës. Theks i veçantë do t'i vihet sigurisë në rrugë përmes kërkesës për revizione të sigurisë në rrugë, ndërtimin e kapaciteteve dhe ngritjen e vetëdijes në kuadër të bashkësive të cilat i janë ekspozuar rrezikut.
Futja e CBAM do të ndikonte seriozisht në konkurrencën e eksportit dhe do të impononte një kosto të lartë në ekonomi duke pasur parasysh intensitetin e karbonit dhe natyrën e orientuar drejt tregtisë së ekonomisë.			Blerja e tokës, kufizimi në shfrytëzimin e tokës dhe shpërngulja e detyrueshme: Sigurimi se të gjitha projektet të cilat kërkojnë blerjen e tokës janë në pajtim me kërkesat e Bankës për kompensim dhe kthimin e kushteve për jetë, me theks të veçantë në dallimet midis BI5 dhe kërkesat kombëtare duke përfshirë të drejtat e abonuesve joformal të tokës dhe grupet e ndjeshme.
Cenueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike përbën një rrezik të konsiderueshëm për infrastrukturën publike dhe zbatimin e projekteve të infrastrukturës.			Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve të gjalla natyrore: Mbështetja e klientëve duke ofruar vlerësime për të siguruar mbrojtjen e specieve dhe habitateve të rëndësishme për ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ekosistemit dhe kapitalit natyror, veçanërisht në sektorë të tillë si energjia e rinovueshme, shërbimet komunale dhe infrastruktura. Sigurimi i zbatimit të praktikave të mira ndërkombëtare në mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të biodiversitetit. Mbase do të nevojiten më shumë mjete si ndihmë teknike për mbështetjen e këtyre aktiviteteve. Eksplorimi i mundësive për rritjen neto të biodiversitetit dhe përmirësimin e rimëkëmbjes së natyrës.
Një deficit i konsiderueshëm fiskal, pjesërisht për shkak të shlyerjes së borxhit të jashtëm, rriti cenueshmërinë ndaj shtrëngimit të kushteve financiare globale. Këshilli Fiskal i sapokrijuar dhe ligji organik i buxhetit do të mbështesin përparimin drejt përputhshmërisë me spirancën fiskale dhe të borxhit.			Trashëgimia kulturore: Punë me klientët për qëllim të identifikimit dhe konsultimit me palët e interesuara kyçe lidhur me projektet në zonat me rëndësi kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë së ndjeshme kulturore. Ndërmjetësit financiarë: Sigurimi se partnerët-ndërmjetësit financiarë kanë përcaktuar kapacitete përkatëse ekologjike dhe sociale dhe procedura për menaxhim me rreziqet. Zbardhja e informacioneve dhe angazhimi i palëve të interesuara: Zbardhja e informacioneve dhe angazhimi i palëve të interesuara: Mbështetja e klientëve në angazhimin proaktiv dhe të hershëm të palëve të interesuara që vazhdon gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit, me fokus në mbrojtjen dhe mosdiskriminimin e njerëzve të prekur nga projekti dhe grupeve të cenueshme, menaxhimin efektiv të ankesave, konsultime dhe raportime transparente, të dokumentuara dhe pjesëmarrëse, përfshirë ato të kryera si pjesë e proceseve lokale të lejeve dhe VNMJÇS.

8. Vlerësimi i partneriteteve me donatorët

Vlerësimi i nevojave gjatë periudhës së strategjisë së re për vendin

Për t'u arritur qëllimet e strategjisë së re të vendit, mund të nevojiten financime nga donatorët për të mbështetur disa aktivitete kryesore:

- Për t'u përmirësuar qasja në financa për gratë dhe të rinjtë, mund të nevojiten instrumente për ndarjen e rrezikut për IFP.
- Për të forcuar konkurrencën e sektorit privat, për të zhvilluar aftësitë dhe për të mbështetur digitalizimin e ekonomisë, do të nevojitet mbështetje në formën e granteve për BT, kryesisht për financimin e shërbimeve këshillimore.
- Për të përshpejtuar tranzicionin në një ekonomi të gjelbër dhe të qëndrueshme, më i nevojshmi do të jetë përdorimi i granteve nxitëse për të stimuluar rritjen e kapaciteteve për prodhimin e energjisë së rinovueshme, kalimin nga burimet e energjisë me shkallë të lartë emetimi dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit të burimeve. Mund të nevojiten edhe grante për BT gjithashtu për të mbështetur formulimin e politikave në këtë fushë dhe për të adresuar pasojat për grupet më të cenueshme të prekura negativisht nga tranzicioni, për shembull me rikualifikimin e punëtorëve.
- Përveç kësaj, grantet e BT mund të jenë të nevojshme për të përmirësuar praktikatat e menaxhimit dhe cilësinë e institucioneve.
- Disa projekte infrastrukturore që përballen me kufizime të detyrueshme në pikëpamje të qasjes mund të kërkojnë bashkë-investim në formën e granteve të shpenzimeve kapitale.

Burimet potenciale të mjeteve të donatorëve


- Sipas Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, BE-ja do të vazhdojë t'i rrisë fondet e saj (grantet dhe garancitë) për projektet prioritare nga sektori publik dhe privat në fushat e transportit, energjisë, mjedisit dhe klimës, digitalizimit, zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe konkurrencën e sektorit privat.
- Disa donatorë dypalësh janë gjithashtu aktivë në vend. Suedia, për shembull, mund të ofrojë grante për BT për projektet komunale, ku ka interes më të madh. Donatorë të tjerë, duke përfshirë Zvicrën, Italinë, Luksemburgun dhe Japoninë, mund të financojnë gjithashtu projekte të BT në vend. Projektet e lidhura me klimën mund të marrin mbështetjen e donatorëve përmes Partneritetit me Ndikim të Lartë për Veprimin për Klimën, i cili është një partneritet me shumë donatorë.
- Fondet shumëpalëshe të klimës, të tilla si Fondi i Gjelbër i Klimës (GCF), Fondi Global i Mjedisit (GEF) dhe Fondi i Investimeve Klimatike (CIF), mund të financojnë përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, si dhe BT për këshilla mbi politikatat.
- Më në fund, burimet koncesionare mund të jenë gjithashtu të disponueshme brenda alokimit rajonal të fondeve nga Fondi Special i Aksionarëve.

Treguesit e zgjedhur të disponueshmërisë

Rangimi rajonal i BERZH-it
në përqindje


BPV për frymor (PFB, vijuese. USD) ²	19,692	50%
NZZH Vend	Yes	N/A
NZZH si pjesë në të ardhurat kombëtare bruto (%) ³	2.56	61%
Shpërndarja e NZZH për frymë (USD – çmimet vijuese) ³	160.82	63%

Financimi i donatorëve gjatë strategjisë së fundit (mil euro)⁴



Përdorimi i mjeteve 2019-2023⁵

Grante për BT



Grante bashkëinvestuese



1. Një renditje e thjeshtë në përqindje e regjistruar si përqindje e ekonomive të BERZH-it të renditura poshtë Maqedonisë së Veriut. 2. SHEB (2023) 3. OECD (2021) 4. Metodologjia për raportimin e shumave të bashkëinvestimit ndryshoi nga bazuar në nënshkrimet e klientëve në bazë të fondeve të dedikuara në nivelin e angazhimit në vitin 2022. Të dhënat për BT 2019-2023 dhe 2022-2023 dhe shumat e fondeve të bashkëinvestimit bazohen në fondet e zotuar në nivelin e detyrimeve, ndërsa shumat e fondeve të bashkëinvestimit 2019-2021 bazohen në nënshkrimet e klientëve. 5. Bazuar në Cilësinë parësore të tranzicionit të burimeve koncesionare.

Anekse



European Bank
for Reconstruction and Development

Aneksi 1 – Vlerësimi politik në kontekst të Nenit 1 (1/7)



European Bank
for Reconstruction and Development

Angazhimi i Maqedonisë së Veriut dhe zbatimi i parimeve politike të përshkruara në Nenin 1 të Marrëveshjes për themelimin e Bankës vazhdoi pas miratimit të Strategjisë së mëparshme të vendit, në përputhje me përpjekjet e saj për zbatimin e agjendës gjithëpërfshirëse të reformave të BE-së.

Është krijuar një kornizë kushtetuese dhe legjislativë për demokracinë pluraliste parlamentare. Ndarja e pushtetit dhe kontrollet dhe balancat në sistemin politik, garancitë për të drejtat themelore dhe mbrojtjen e pakicave dhe për një rol të rëndësishëm të shoqërisë civile janë kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, siç vlerësohet nga Këshilli i Evropës.

Pavarësisht progresit në reformat demokratike ndër vite, duke përfshirë disa valë reformash në gjyqësi, sfida të rëndësishme mbeten në fushën e sundimit të ligjit, duke përfshirë nevojën për të përforcuar pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit (dhe besimin publik në gjyqësor) dhe krijimin e një evidence solide të luftës me korrupsionin, duke përfshirë hetime, përndjekje dhe gjykime të rasteve me profile të larta.

Zgjedhjet e kombinuara presidenciale dhe parlamentare, të cilat u zhvilluan në maj 2024, sollën në pushtet, pas shtatë vitesh në opozitë, partinë konservatore VMRO-DPMNE. Qeveria e re e koalicionit e udhëhequr nga VMRO-DPMNE mori detyrën më 23 qershor 2024.

Maqedonia e Veriut ishte vendi i parë nga Ballkani Perëndimor që iu dha statusi zyrtar i vendit kandidat për në BE, në vitin 2005, ndërsa Komisioni Evropian dha rekomandim për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE. Megjithatë, për shkak të kontestit të emrit me Greqinë dhe mungesës së mëvonshme të konsensusit në Këshillin Evropian, madje në vitin 2020 ai mund të mbështeste vendimin për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE. Edhe pse Konferenca Ndërqeveritare (fillimi simbolik i negociatave) u zhvillua në vitin 2022, e ndjekur nga një “skrining” pasues i suksesshëm gjatë viteve 2022-2023, negociatat nuk filluan kurrë me një intensitet më serioz. Kushti aktual i BE-së, bazuar në kërkesën e Bullgarisë fqinje, është që Parlamenti i Maqedonisë së Veriut të miratojë ndryshimet kushtetuese në lidhje me statusin e bullgarëve në Maqedoninë e Veriut.

Mekanizmi i reformës dhe rritjes sipas Planit të ri të Rritjes së BE-së për

Ballkanin Perëndimor përfaqëson një mekanizëm potencialisht të rëndësishëm për menaxhimin dhe mbështetjen e reformave gjithëpërfshirëse. Qeveria e re e Maqedonisë së Veriut, e formuar në qershor 2024, e paraqiti agjendën e saj të reformave në kuadër të mekanizmit të lartpërmendur në korrik 2024. E njëjta u aprovua nga BE-ja më 23 tetor 2024.

ZGJEDHJE TË LIRA DHE QEVERI PËRFAQËSUESE

Zgjedhje të lira, të drejta dhe konkurruese

Nga 120 deri në 123 deputetë në parlamentin njëdhomësh janë zgjedhur për një mandat katërvjeçar përmes një sistemi të përfaqësimit proporcional. Prej tyre u zgjodhën nga 20 deputetë në secilën nga gjashtë njësitë zgjedhore në vend. Në një zonë zgjedhore jashtë vendit zgjidhen maksimum tre deputetë shtesë. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është organ i pavarur i përhershëm, i emëruar nga Kuvendi me mandat katërvjeçar. Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e brendshëm dhe ndërkombëtar të zgjedhjeve në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.

Korniza ligjore ekzistuese ofron një bazë të fortë për zgjedhje demokratike, me kusht që autoritetet dhe partitë politike të tregojnë gatishmëri të mjaftueshme për zbatimin e tyre. Seria e reformave të zbatuara ndër vite solli përfitime pozitive në kornizën ligjore dhe përfshinte shumë rekomandime të mëparshme nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias).

Zgjedhjet janë përgjithësisht konkurruese dhe respektohen liritë themelore. Në të njëjtën kohë, disa rregulla të zgjedhjeve parlamentare nuk janë në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare, duke i përfshirë të drejtat e votimit të personave me aftësi të kufizuara, kufizimet joproporcionale të të drejtave të kandidaturës bazuar në akuzat penale dhe kërkesat për zbulimin e përkatësisë etnike për qëllime regjistrimi si kandidat. Ekzistojnë disa mospërputhje, zbrazëtira dhe paqartësi të vazhdueshme që e kërcënojnë sigurinë juridike. Një numër i madh i rekomandimeve të ODIHR dhe Komisionit të Venecias akoma janë të pazgjidhura.

Aneksi 1 – Vlerësimi politik në kontekst të Nenit 1(2/7)



European Bank
for Reconstruction and Development

Ekziston edhe një praktikë shqetësuese e ndryshimit të kornizës ligjore pak para zgjedhjeve. Në rastin e zgjedhjeve të fundit të përgjithshme, të cilat u mbajtën në maj 2024, Kodi Zgjedhor u ndryshua për herë të fundit më 1 prill 2024, tashmë pas shpalljes së zgjedhjeve, gjë që e cenonte sigurinë juridike. Në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardeve ndërkombëtare, ndryshimet që rezultuan nga negociatat mes partive në pushtet dhe opozitës, u miratuan pas një procedure të shkurtuar, pa diskutim publik.¹

Zgjedhjet e fundit parlamentare, të cilat u mbajtën më 8 maj 2024, njëkohësisht me raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale (raundi i parë i këtyre zgjedhjeve u mbajt më 24 prill 2024), u vlerësuan nga OSBE/ODIHR si mirë të organizuara dhe konkurruese, ndërsa vetë dita e zgjedhjeve paqësore dhe pa incidente. Por përveç zbrazëtirave të sipërpërmendura në rregullim dhe proces, në disa raste është rishfaqur edhe problemi i vjetër i votimit në grup dhe familjar.

Ndarja e pushtetit dhe kontrollet efektive dhe ekuilibrimi

Korniza kushtetuese dhe legjislative për demokracinë parlamentare – e mbështetur nga ndarja e pushteteve dhe kontrollet dhe balancat në sistemin politik, legjislacioni i pavarur dhe procedurat për mbikëqyrjen legjislative në domenet e përcaktuara vendimmarrëse – garantohet në Kushtetutën dhe ligjet e Maqedonisë së Veriut, të cilat janë kryesisht të harmonizuara me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, siç vlerësuan nga Këshilli i Evropës dhe BE-ja. Fusha e autorizimeve të legjislaturës për të siguruar llogaridhënien e qeverisë dhe për të ushtruar mbikëqyrjen parlamentare është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Maqedonia e Veriut është një demokraci parlamentare ku Kuvendi ka fuqi legjislative dhe zgjedh qeverinë. Pushteti ekzekutiv udhëhiqet nga Kryeministri, i cili zakonisht është lider i partisë më të madhe parlamentare. Presidenti zgjidhet drejtpërdrejt, por është kryesisht një figurë ceremoniale. Avokati i Popullit, i cili zgjidhet nga Kuvendi, ka për detyrë të promovojë dhe mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe merr funksionin e Institucionit Kombëtar për të Drejtat e Njeriut.

Fuqia efektive për qeverisje e funksionarëve të zgjedhur

Maqedonia e Veriut ka krijuar rregullime institucionale, ligjore dhe financiare në mënyrë që funksionarët e zgjedhur të kenë fuqi efektive për të qeverisur dhe të mos kufizohen nga të drejtat jodemokratike të vetos ose ndikime të tjera të padrejta. Ashtu si me shumë vende të tjera në tranzicion, ekziston një marrëdhënie e gjatë e ngushtë midis biznesit dhe elitave politike.

SHOQËRIA CIVILE, MEDIAT DHE PJESËMARRJA Fushëveprimi dhe pavarësia e shoqërisë civile

Ekziston një kornizë ligjore e kënaqshme për organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Më shumë se 15.500 shoqata dhe fondacione janë aktualisht të regjistruara në Regjistrin Qendror, bazuar në një procedurë të thjeshtë dhe transparente të regjistrimit në përputhje me Ligjin për Shoqata dhe Fondacione. Këshilli për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile është kanali kryesor strukturor për konsultim dhe përfshirje të shoqërisë civile në dialogun politik dhe vendimmarrje.

Kornizat ekzistuese ligjore dhe financiare duhet të përmirësohen akoma, veçanërisht për të siguruar mekanizma të qëndrueshme për ndarjen e fondeve publike për OSHC-të. Si kudo në Ballkanin Perëndimor, organizatat e shoqërisë civile mbeten kryesisht të varura nga financimi i huaj.

Disa organizata të shoqërisë civile janë shumë profesionale në fushat e tyre përkatëse të ekspertizës, veçanërisht ato të specializuara në çështjet që lidhen me integrimin në BE, mjedisin, mediat dhe çështjet gjinore. Organizatat e shoqërisë civile janë aktive në fushën sociale, duke përfshirë mbrojtjen e grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara, si dhe në vëzhgimin e zgjedhjeve. Një pjesë e dobësive në këtë drejtim është edhe zhvillimi i shoqërisë civile në nivel lokal, veçanërisht në zonat rurale. Në përgjithësi, organizatat e shoqërisë civile në Maqedoninë e Veriut vazhdojnë të punojnë në një mjedis të kënaqshëm mundësues dhe të luajnë një rol kyç në mbështetjen e proceseve demokratike.

Të drejtat për të krijuar sindikata janë të përcaktuara me ligj dhe respektohen në praktikë. Këshilli Ekonomiko-social luan një rol gjithnjë e më aktiv në dialogun social. Është gjithashtu e nevojshme që Këshilli për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile të vazhdojë aktivitetet e tij.

¹ OSBE/ODIHR, Maqedonia e Veriut, Zgjedhje parlamentare dhe Zgjedhje presidenciale, raundi i dytë, 8 maj 2024, Deklaratë e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake.

Pavarësia dhe pluralizmi i mediave të cilat punojnë pa censurë

Peizazhi mediatik është i larmishëm, me 40 stacione televizive dhe 58 radio, si dhe 22 media të shkruara që operojnë në një treg relativisht të vogël. Media kryesore është servisi radiodifuziv publik, Radio-Televizioni i Maqedonisë (RTM), i cili i ka pesë kanale të ndryshme. Pavarësisht se televizioni është burimi kryesor i informacionit, portalet onlajn kanë një ndikim gjithnjë e më të rëndësishëm në mjedisin mediatik. Autletët mediatikë, duke përfshirë median e shkruar, tirazhi i të cilave është relativisht i ulët, është i ndarë në vija politike dhe etnike, duke reflektuar polarizimin e përgjithshëm në shoqëri. Ky fragmentim politik dhe ndarje etnike, konkurrenca intensive mes mediave të shumta në një treg të kufizuar dhe kushtet e pafavorshme të punës së gazetarëve ndikojnë negativisht në cilësinë e gazetarisë. Lidhjet e ngushta mes disa pronarëve të mediave dhe aktorëve politikë në Maqedoninë e Veriut shpesh çojnë në autocensurë.

Megjithëse ndryshimet e vitit 2022 në Ligjin për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje dhe ndryshimet e vitit 2023 në Kodin Penal futën masa mbrojtëse shtesë për gazetarët, sulmet në internet dhe incidentet e izoluar të sulmeve fizike ndaj gazetarëve mbeten problem.²

Shkalla e depërtimit të internetit është vazhdimisht në rritje. Mediat sociale po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Edhe pse korniza ligjore është kryesisht e vendosur dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, shqetësimet në të kaluarën kanë qenë tradicionalisht rreth autocensurës dhe mungesës së pavarësisë editoriale për shkak të interesave politike dhe afariste.

Raporti i fundit i BE-së për sundimin e ligjit e vlerësoi pozitivisht aftësinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për të përmbushur detyrat e saj rregullatore³. Monitoruesi i Pluralizmit të Medias (MPM) nga viti 2024 tregoi se pavarësia dhe efektiviteti i autoritetit të medias është një fushë me rrezik të ulët⁴. Sfidat mbeten në lidhje me transparencën e pronësisë së mediave.

² Raporti i BE-së për sundimin e ligjit 2024, Kapitulli për Maqedoninë e Veriut, 24.7.2024

³ *ibid.*

⁴ 2024 Monitorimi i pluralizmit mediatik për Maqedoninë e Veriut

⁵ Raporti i BE-së për sundimin e ligjit 2024, Kapitulli për Maqedoninë e Veriut, 24.7.2024.

Kanale të shumëfishta të pjesëmarrjes qytetare dhe politike

Janë identifikuar kanale të shumta të pjesëmarrjes qytetare dhe politike. Ekzistojnë rregulla dhe procedura të caktuara në lidhje me konsultimet publike, por ato nuk zbatohen gjithmonë. Për shembull, një sistem kombëtar konsultimi elektronik që lejon palët e interesuara të marrin pjesë në konsultimet publike ekziston dhe është mjaft i avancuar, por vetëm një numër i kufizuar projektligjesh publikohen në platformën përkatëse (më pak se 50% e projektligjeve në periudhën e fundit⁵).

Pjesëmarrja e OSHC-ve në procesin e hartimit të politikave parashikohet në Rregulloren e Punës së Qeverisë, në Kodin e Praktikave të Mira për pjesëmarrjen e OSHC-ve në procesin e zhvillimit të politikave, në Metodologjinë për vlerësimin e ndikimit të rregullores dhe në Udhëzimin për ministritë që kryejnë vlerësimin e ndikimit të rregullores. Megjithatë, që nga viti 2022, organizatat e shoqërisë civile kanë bojkotuar Këshillin për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, i cili është kanali kryesor strukturor për konsultim dhe përfshirje të shoqërisë civile në dialogun politik dhe vendimmarrje.

Liria e formimit të partive politike dhe ekzistenca e një opozite të organizuar

Liria e formimit të partive politike është e garantuar me Kushtetutë dhe realizohet në kuptimin praktik, gjë që theksohet nga ekzistenca e një opozite të konsiderueshme që lirisht mund të zhvillojë fushata dhe të kundërshtojë iniciativat qeveritare. Në zgjedhjet e fundit të përgjithshme në Maqedoninë e Veriut morën pjesë 12 parti politike dhe pesë koalicione. Partia kryesore politike opozitare aktualisht mban rreth 15 për qind të vendeve në parlamentin kombëtar, përfaqësuesit e saj kryesojnë disa komisione kyçe dhe e kanë shumicën në disa komuna.

Aneksi 1 – Vlerësimi politik në kontekst të Nenit 1 (4/7)



European Bank
for Reconstruction and Development

SUNDIMI I LIGJIT DHE QASJA NË DREJTËSI

Sundimi i ligjit

Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut përcakton pavarësinë e gjykatave dhe autonominë e prokurorisë. Edhe pse ekzistojnë dispozita ligjore, megjithatë ekziston një hendek midis kornizës ligjore dhe praktikës. Maqedonia e Veriut ka një sistem gjyqësor me tre nivele, i përbërë nga 27 gjykata të shkallës së parë, katër gjykata të Apelit dhe Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme është instanca më e lartë në sistemin gjyqësor me kompetenca për të siguruar zbatimin e barabartë të ligjeve nga të gjitha gjykatat. Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e gjyqësorit dhe ndër të tjera shqyrton kushtetutshmërinë e ligjeve.

Pavarësia e gjyqësorit

Pavarësia e gjyqësorit garantohej me Kushtetutë dhe vendi ka një sërë rregullash gjithëpërfshirëse të cilat, nëse respektohen, duhet të sigurojnë një standard të lartë të gjyqësorit dhe pavarësinë e tij të plotë. Megjithatë, pavarësisht valëve të shumta të reformave në drejtësi që synojnë përmirësimin e pavarësisë, efikasitetit dhe profesionalizmit të gjyqësorit, pavarësia e gjyqësorit dhe kapaciteti institucional për ta mbrojtur atë nga ndikimet e padrejta vazhdojnë të jenë një problem serioz⁶. Niveli i pavarësisë së perceptuar të gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut është shumë i ulët si nga publiku i gjerë ashtu edhe nga kompanitë. Në përgjithësi, 25% e popullsisë së përgjithshme dhe 20% e kompanive e konsiderojnë nivelin e pavarësisë së gjykatave dhe gjykatësve si “mjaft ose shumë të mirë”. Si shkakun kryesor që e potencojnë edhe opinionin i gjerë edhe kompanitë për mungesën e pavarësisë së gjykatave dhe gjykatësve është perceptimi i ndërhyrjes apo presionit nga Qeveria dhe politikanët⁷.

Maqedonia e Veriut ka ndërmarrë një sërë reformash gjyqësore, veçanërisht në lidhje me “Prioritetet urgjente reformuese” të vitit 2015, rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe ato të Grupit të lartë të ekspertëve për çështje sistemore të sundimit të ligjit⁸. Në dhjetor 2023, qeveria e miratoi një strategji të re të sektorit gjyqësor 2024-2028 për përmirësimin e pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit. Ajo përfshiu një numër të madh masash shtesë me ato të parapara me strategjinë paraprake. Paralajmërimi i Qeverisë të re në vitin 2024 për planet e “shkarkimit” të Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorëve u cilësua nga BE-ja si “çështje e cila shqetëson realisht, pasi aktivitetet e tilla do ta minojnë pavarësinë e gjyqësisë.”⁹

Qeveria dhe qytetarët i nënshtrohen njëloj ligjit

Kushtetuta e garanton barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit. Në vitin 2022 u krijua Këshilli për Gjyqësor të Hapur, i cili në shkurt të vitit 2024 e miratoi Planin e veprimit për gjyqësor të hapur (2024-2026). Plani i veprimit është hartuar për t'i përmirësuar marrëdhëniet me opinionin midis gjykatave dhe opinionit, për të rritur cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave dhe informacionit dhe për të forcuar funksionin mbikëqyrës të Këshillit Gjyqësor për transparencën e gjykatave.

Politika efektive dhe institucione për parandalimin e korrupsionit

Bazuar në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (IPK) të Transparenci Interneshënall, perceptimet për situatën në këtë fushë janë përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme gjatë periudhës që nga miratimi i Strategjisë së mëparshme të vendit, siç tregohet nga rezultati më i lartë i vendit (nga 35 në vitin 2020, 42 në vitin 2023). Maqedonia e Veriut e ka përmirësuar pozicionin e saj për sa i përket IPK-së dhe tani renditet në vendin e 88-të nga 180 vende (ishte e 111-ta në vitin 2020).

⁶ Njëjtë

⁷ Anketa e Eurobarometrit, FL540, e kryer në mesin e publikut të gjerë midis 14-27 shkurt 2024 dhe Anketa e Eurobarometrit FL541, e kryer midis kompanive midis 14 shkurtit dhe 5 marsit 2024

⁸ Grupi i Ekspertëve të Lartë të Pavarur për Sundimin e Ligjit u kërkua nga Komisioni Evropian në vitin 2015 që të vlerësonte çështjet sistematike mbi sundimin e ligjit, të cilat dhanë bazën për Prioritetet Urgjente të Reformës. Në vitin 2017, i njëjti grup vlerësoi progresin në adresimin e gjetjeve të tyre të mëparshme dhe bëri rekomandime të reja. U dorëzuan 15 parashtresa për çështjen e legjitimitetit të disa vendimeve të miratuara nga Kuvendi gjatë asaj periudhe që ndikuan në zhvillimin afatgjatë të vendit.

⁹ Raport për Maqedoninë e Veriut 2024, së bashku me vitin 2024. BE Politikë e zgjerimit, raport i Komisionit Evropian, 30.10.2024.

Megjithatë, në realitet korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe progresi viteve të kaluara nuk është mjaftueshëm i lartë. Megjithëse korniza ligjore është vendosur, masat kundër korrupsionit duket se vazhdojnë të kenë ndikim të kufizuar në sektorët e cënueshëm, jo vetëm për shkak të mungesës së një qasjeje sistematike¹⁰. Institucionet e përkushtuara kanë më pak burime dhe ekspertizë, veçanërisht në fushën e hulumtimit financiar. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare gjithëpërfshirëse për Parandalimin e Korrupsionit për 2021-2025 ishte vetëm i pjesshëm: nga 166 aktivitete të planifikuara për vitin 2023, për shembull, u zbatuan vetëm 22 (13%)¹¹. Ndryshimet e shpeshta në kuadrin ligjor dëmtojnë sigurinë juridike. Kodi Penal, për shembull, është ndryshuar mbi 30 herë që nga miratimi i tij në 1996. Ndryshimet e fundit, të miratuara nga parlamenti në vitin 2023, u miratuan pas një procedure të shkurtuar dhe pa konsultim paraprak me palët përkatëse të interesit. Komisioni Evropian ka shprehur "shqetësime serioze" në lidhje me ndryshimet në veprat penale të lidhura me korrupsionin, të cilat reduktojnë dënimet maksimale për disa vepra specifike, duke përfshirë shpërdorimin e detyrës, ndalimin apo edhe ndalimin e një numri rastesh të korrupsionit të nivelit të lartë¹². Keqpërdorimi i pozitës zyrtare në furnizimet publike është hequr tërësisht nga Kodi Penal. Sipas BE-së, vendi duhet të miratojë një Kod të ri Penal, në përputhje me dispozitat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare (hetimi financiar, konfiskimi i pronës, mbikëqyrja e financimit të zgjedhjeve, etj.)

Përbërja e re e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), e cila u emërua nga Kuvendi, seancën e parë konstituive e mbajti në shkurt të vitit 2024. KSHPK është organ koordinues për monitorimin e zbatimit të masave nga Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit, verifikimin e pronës, konfliktin e interesit dhe papajtueshmërinë. Institucionet kryesore të përfshira në represionin e korrupsionit janë Departamenti i Specializuar për Krim të Organizuar dhe Korrupsion në Gjykatën Penale të Shkupit, Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Njësia e Specializuar e Policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policia Financiare, Drejtoria e Doganës dhe Drejtoria e Zbulimit Financiar. KSHPK, sipas vlerësimit të KE-së, ka qenë proaktive në ofrimin e udhëzimeve për politikën e institucioneve publike për parandalimin e korrupsionit, por ka pasur një mungesë relative të ndjekjes së rekomandimeve të saj.

TË DREJTA QYTETARE DHE POLITIKE

Liria e fjalës, informacionit, religjionit, ndërgjegjes, lëvizjes, shoqatave, tubimeve dhe pronës private

Maqedonia e Veriut është nënshkruese e të gjitha instrumenteve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Niveli i lartë i ratifikimit të konventave të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe instrumenteve rajonale të të drejtave të njeriut paraqet një arritje të rëndësishme. Maqedonia e Veriut gjithashtu ka krijuar një kornizë institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e cila përfshin edhe Avokatin e popullit.

Vlerësimi i fundit i të dhënave të deritanishme të Maqedonisë së Veriut për të drejtat e njeriut në kuadrin e Shqyrtimit periodik universal (SHPU) të Kombeve të Bashkuara u miratua në vitin 2019. Tre rekomandimet kryesore lidhen me të drejtat e grave (22 për qind e rekomandimeve), të drejtat e fëmijëve (19 për qind) dhe të drejtat e pakicave (15 për qind). Maqedonia e Veriut mbështeti 99 për qind të gjithsej 171 rekomandimeve të bëra gjatë procesit të rishikimit.¹³

Kushtetuta dhe ligjet përkatëse ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë, racës, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose sociale, pronës ose statusit shoqëror. Kushtetuta i garanton liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve të njohura në të drejtën ndërkombëtare, ndërsa marrëveshjet ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt nga gjykatat vendore dhe statusi i tyre është superior ndaj ligjit të brendshëm. Rrjedhimisht, liria e fjalës, informacioni, feja, ndërgjegjja, lëvizja, shoqërimi, tubimi dhe prona private janë plotësisht të garantuara. Kushtetuta, gjithashtu kërkon që shteti ta plotësojë iniciativën dhe përgjegjësinë private në lidhje me disa "qëllime shoqërore", si për shembull kujdesi për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe jetimët.

Sa i përket të drejtave pronësore, është bërë progres në kthimin e pronave të konfiskuara nën regjimin komunist. Megjithatë, sipas KE-së, strategjia kombëtare e të drejtave pronësore nuk është avancuar. Mbi 6.000 raste të denacionalizimit mbeten të hapura, pavarësisht se procesi është përfunduar zyrtarisht një dekadë më parë.¹⁴

¹⁰ Raporti i skringut i BE-së, Maqedonia e Veriut, Klasteri 1 (baza), 2023.

¹¹ KSHPK Raport vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, 2024

¹² Raporti për Maqedoninë e Veriut 2023 i shoqëruar me Politikën e BE-së për zgjerim 2023, Komisioni Evropian, 08.11.2023

¹³ Raporti për Maqedoninë e Veriut 2024 i shoqëruar me Politikën e BE-së për zgjerim 2024, Komisioni Evropian, 30.10.2024

¹⁴ Statistika UPR është në dispozicion në <https://upr-info-database.uwazi.io/en/>

Përfshirja politike për gratë, pakicat etnike dhe të tjera

Korniza ligjore për mbrojtjen e pakicave etnike është krijuar gjerësisht. Vendi ka një përbërje komplekse etnike. Sipas regjistrimit të vitit 2021, maqedonasit etnikë përbëjnë 58,44% të popullsisë rezidente, shqiptarët etnikë 24,3%, turqit etnikë 3,86%, romë 2,53%, serbët etnikë 1,3%, boshnjakët etnikë 0,87% dhe vllahët 0,47%.

Maqedonia e Veriut ka një histori tensionesh etnike. Megjithatë, ajo ka bërë përpunim që nga konflikti i armatosur ndëretnik i vitit 2001 në zgjidhjen e rrënjëve dhe efekteve të këtij konflikti. Këto përpjekje përfshinin reforma legjislative dhe masa praktike të dizajnuara për të siguruar përfaqësim të drejtë të komuniteteve pakicë në administratën publike dhe integrimin e tyre në shoqëri dhe promovimin e pajtimit ndëretnik. Interesat e komuniteteve pakicë mbrohen në nivele të ndryshme, duke filluar nga garancitë themelore kushtetuese (komunitetet etnike përmenden shprehimisht në Kushtetutë) deri te mekanizmi i veçantë që siguron mbrojtjen e interesave të tyre në Kuvend dhe masat për mbrojtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe fetar. Ekziston një strategji e veçantë kombëtare për promovimin e shoqërisë multi-etnike: "Një shoqëri për të gjithë dhe ndërkulturalizmi". Rezultatet më të prekshme në këtë drejtim janë arritur në mbrojtjen e interesave dhe sigurimin e përfaqësimit të drejtë të pakicës më të madhe etnike, shqiptarëve. Mbetet më shumë për t'u bërë për të mbrojtur pakicat më të vogla etnike, siç është komuniteti rom i cënueshëm.

Pavarësisht progresit të arritur, tensionet ndëretnike vazhdojnë, veçanërisht në nivel lokal. Partitë politike janë të ndara kryesisht në vija etnike. Zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit (MO), e cila në mënyrë të prerë përfshin pajtimin ndëretnik, mbetet e pandryshueshme. Ajo vazhdon të mbështesë stabilitetin politik, i cili është theksuar nga koalicionet e njëpasnjëshme qeveritare shumë-etnike.

Për romët janë marrë disa masa. Është prezantuar Strategjia për përfshirjen e romëve 2022-2030. Vazhduan të zbatoheshin projekte arsimore, të cilat çuan në një rritje të lehtë të shkallës së regjistrimit të fëmijëve romë në arsim. Megjithatë, shkalla vjetore e braktisjes së shkollës së fëmijëve romë është ende relativisht e lartë. Mungesa e aftësive digjitale dhe qasja në teknologji vazhdojnë t'i pengojnë romët të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre dhe qasjen në shumicën e shërbimeve, shumica e të cilave janë digjitale (kujdesi shëndetësor, arsim,

punësim, mbrojtje sociale, etj.). Qasja në shërbimet shëndetësore parandaluese dhe kurative, ulja e vdekshmërisë, përballja me diskriminimin dhe trajtimin e pabarabartë nga profesionistët shëndetësorë dhe shëndeti i grave mbeten sfidat kryesore në fushën e kujdesit shëndetësor rom. Ndryshimet në Ligjin për Librat amzë, Ligjin për Regjistrimin e Vendbanimit dhe Ligjin për Letërnjoftimet i hapin rrugë zgjidhjes së rasteve të pashtetësisë dhe përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare të vendit në këtë drejtim.

Elementet kryesore legjislative për barazinë gjinore janë në fuqi në Maqedoninë e Veriut. Vendi e ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave (Konventa e Stambollit), ndërsa Ligji Kombëtar për Parandalimin dhe Mbrojtjen kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje u miratua në vitin 2021. Në vitin 2023, janë bërë ndryshime në Kodin Penal, i cili rregullon krimet e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë krimet e "përndjekjes" dhe "urrejtjes bazuar në identitetin gjinor dhe dallimet gjinore". Por ligji për barazi gjinore nuk është miratuar akoma.

Sipas standardeve rajonale (dhe më gjerë ndërkombëtare), gratë kanë pasur një përfaqësim mbresëlënës në parlamentin kombëtar gjatë dekadës së fundit. Ajo arriti kulmin e saj në 42.5 për qind në parlamentin e kaluar dhe në parlamentin aktual është 36 për qind. Në përputhje me kuotën e shtuar për pjesëmarrjen e grave, të vendosur nga Kodi Zgjedhor (ritje nga 30 në 40 për qind), 43 për qind e kandidatëve në zgjedhjet e fundit të përgjithshme ishin gra. Në maj të vitit 2024, për herë të parë në historinë e vendit, një grua u zgjodh Presidente e Maqedonisë së Veriut.

Aneksi 1 – Vlerësimi politik në kontekst të Nenit 1 (7/7)



European Bank
for Reconstruction and Development

Në të njëjtën kohë, ka hendeqe të vazhdueshme gjinore në punësimin dhe pjesëmarrjen në fuqinë punëtore.

Paragjykimet sociale dhe stereotipet negative mbizotërojnë në shoqëri, ndërsa gjuha e urrejtjes kundër LGBTIQ është e pranishme në media dhe rrjete sociale, si dhe në tekstet shkollore. Nuk ka progres në zbatimin e vendimit të GJEDNJ-së nga viti 2019 në lidhje me njohjen ligjore të gjinisë me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Librin Amëz të të Lindurve. Korniza ligjore nuk lejon njohjen zyrtare të çifteve të së njëjtës gjini. Sipas raportit të fundit të zhvillimit të BE-së, nuk ka pasur përparim të përgjithshëm në përmirësimin e kornizës ligjore ose të politikave për mbrojtjen e të drejtave të personave të komunitetit LGBTIQ.¹⁵

Liri nga ngacmimet, frikësimet dhe torturat

Garancitë kushtetuese kundër ngacmimit, frikësimit dhe torturës ekzistojnë dhe respektohen në masë të madhe në praktikë. Një delegacion i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT) i Këshillit të Evropës ka bërë një vizitë periodike në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023. Në raport u potencuan konsultimet konstruktive dhe bashkëpunimi i mirë me autoritetet e vendit. Megjithatë, u konstatua se nuk ka pasur përmirësim në trajtimin e personave të privuar nga liria nga policia që nga vizita e saj në vitin 2019. Në raport potencohet se shumë njerëz dolën me akuza për keqtrajtim nga policia. KPT e përsëriti pikëpamjen se reforma strategjike e sistemit të burgjeve duhet të përqendrohet në çrrënjosjen e korrupsionit midis personelit dhe profesionalizimin e udhëheqësisë së burgjeve nëpërmjet emërimeve transparente, të bazuara në merita dhe të depolitizuara, si dhe në sigurimin e vendosjes së tyre hierarkike të administratës së burgjeve.¹⁶

Mekanizmi për mbikëqyrjen e jashtme të policisë, përfshirë policinë e burgjeve, nuk është ende plotësisht funksional. Maqedonia e Veriut duhet të përballlet me çështjen e vazhdueshme të kushteve joadekuate të paraburgimit në burgje, stacione policore, në mjedise të mirëqenies sociale dhe psikiatrike, në përputhje me rekomandimet në raportet e KPT-së. Jurisprudenca e GJEDNJ-së tregon se kushtet e këqija të paraburgimit mund të konsiderohen si arsye për shkeljen e nenit 3 për ndalimin e torturës¹⁷.

¹⁴Raporti për Maqedoninë e Veriut 2024 i shoqëruar me Politikën e BE-së për zgjerim 2024, Komisioni Evropian, 30.10.2024

¹⁵Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT), Raport për vizitën periodike në Maqedoninë e Veriut nga 2 deri më 12 tetor 2023, botuar më 15 maj 2024.

¹⁶Raport për Maqedoninë e Veriut 2023 i shoqëruar me Politikën e BE-së për zgjerim 2023, Komisioni Evropian, 08.11.2023